



**Universiteti Bujqësor i Tiranës,
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

**në kuadrin e 100 vjetorit të lindjes së Akademikut Prof. Dr. Mentor Përmeti,
organizojnë:**

KONFERENCËN

***Bujqësia, një Shkencë Jetësore
me rrënjët në Biologjinë e Aplikuar***

Agriculture a Life Science with roots in Applied Biology



Koha: 3 dhe 4 Dhjetor 2020

Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë



Akademik Mentor PËRMETI

Mentor PËRMETI (1920–2015). Agronom, profesor, akademik. Lindi në Tiranë, ku kreu dhe gjimnazin. Mori pjesë në Luftën ANÇ. Pas çlirimit ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në Akademinë e Shkencave Bujqësore “Georgi Dimitrov” në Sofje (1951). U emërua drejtor drejtorisë së bimëve të arave (1951–1962) e më pas zv.ministër (1962–1967) në Ministrinë e Bujqësisë; në v. 1967–1977 qe përgjegjës i katedrës së seleksionimit të bimëve dhe rektor i *Institutit të Lartë Bujqësor*; kryeagronom në NB në Lushnjë (1977–1982), zv.kryetar i Komitetit të Shkencës dhe Teknikës (1982–1987). Me veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore ka dhënë ndihmesë në seleksionimin dhe përmirësimin gjenetik të grurit, duke krijuar kultivarë të rinj me prodhimtari të lartë, që vazhdojnë të kultivohen; ka studiuar vargëzimin gjithëvjeter të ushqimeve të gjelbra për gjedhin. Bashkautor i monografsë “Linjat bazë të përmirësimit gjenetik të misrit” (1987) dhe i teksteve “Seleksionimi i bimëve dhe prodhimi i farërave” (1970), “Gjenetika” (1971), si dhe i një vargu artikujsh shkencorë. Është dekoruar me Urdhrin “Mjeshtër i Madh i Punës”, ka marrë titullin “Punonjës i Shquar i Shkencës dhe i Teknikës” dhe “Çmimin e Republikës” të shkallës së dytë.

President i Konferencës: *Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës*

Komiteti Shkencor i Konferencës

1. Fatbardh Sallaku (Kryetar)
2. Efigjeni Kongjika (anëtar)
3. Nazim Gruda (anëtar)
4. Sulejman Sulçe (anëtar)
5. Adem Salillari (anëtar)
6. Alban Ibraliu (anëtar)
7. Anila Hoda (anëtar)
8. Arjola Bacu (anëtar)
9. Arsen proko (anëtar)
10. Evan Rroço (anëtar)
11. Fadil Thomai (anëtar)
12. Ferdinand Bego (anëtar)
13. Ilija Mikerezi (anëtar)
14. Irfan Tarreli (anëtar)
15. Kristaq Teneqexhiu (anëtar)
16. Ndoc Fasllia (anëtar)
17. Petrit Rama (anëtar)
18. Vjollca Ibro (anëtar)
19. Vladimir Malo (anëtar)
20. Xhelil Koleci (anëtar)

Komiteti Organizativ i Konferencës

1. Belul Gixhari (Kryetar)
2. Agim Canko (anëtar)
3. Alban Ibraliu (anëtar)
4. Anila Hoda (anëtar)
5. Arsen Proko (anëtar)
6. Astrit Balliu (anëtar)
7. Fetah Elezi (anëtar)
8. Foto kashta (anëtar)
9. Endrit Kullaj (anëtar)
10. Ilir Salillari (anëtar)
11. Kostandin Hajkoja (anëtar)
12. Naim Laçej (anëtar)
13. Najada Kadasi (anëtar)
14. Nikollaq Bardhi (anëtar)
15. Rigers Bakiu (anëtar)
16. Roland Meçaj (anëtar)
17. Sokrat Jani (anëtar)
18. Tatjana Dishnica (anëtar)
19. Valbona Hobdari (anëtar)
20. Vath Tabaku (anëtar)

Të nderuar Kolegë

Në emër të Komitetit Shkencor dhe Organizativ, kemi kënaqësinë t'ju ftojmë të merrni pjesë në konferencën “*Agriculture a Life Science with roots in Applied Biology*” që do të zhvillohet në **3-4 Dhjetor 2020**.

Konferenca organizohet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Konferenca do të zhvillohet në mjediset e Universitetit Bujqësor të Tiranës, qendra e vetme në Shqipëri që ofron dije dhe programe studimi në shkencat Bujqësore dhe Biologjike të Aplikuara.

Objektivi kryesor i konferencës do të jetë diskutimi i metodave bashkëkohore që përdoren në fushën e resurseve gjenetike bimore, shtazore, shkencat e ushqimit dhe mjedisit. Konferenca do të jetë një mundësi për specialistët e ndryshëm, kërkuesit dhe shkencëtarët të prezantojnë punën e tyre, të njihen me teknikat dhe metodat më moderne të përdorura, si dhe me rezultatet më të fundit të përfutur në fushën e studimit të resurseve gjenetike bimore dhe shtazore, ndikimin e tyre në cilësinë e ushqimit dhe mjedisit. Konferenca do jetë gjithashtu një mundësi dhe një mjedis i përshtatshëm për të vendosur kontakte të reja dhe për të diskutuar perspektivat e mundshme të bashkëpunimit midis kërkuesve, akademikëve dhe shkencëtarëve. Organizatorët kanë kënaqësi të veçantë t'ju ftojnë të merrni pjesë dhe të paraqisni punimet tuaja në formën e referimeve apo posterave.

Ju presim me kënaqësi të takohemi më 3 dhe 4 Dhjetor 2020 në Universitetin Bujqësor të Tiranës!

Fushat e konferencës

Konferenca do të fokusohet në arritjet e kohëve të fundit në fushat:

- Biologji e aplikuar dhe Resurse gjenetike bimore
- Biologjie aplikuar dhe Resurse gjenetike shtazore
- Biodiversiteti dhe mjedisi

Data të rëndësishme

Regjistrimi dhe dorëzimi i abstrakteve	20 Shtator 2020
Njoftimi mbi pranimin e abstraktit	5 Tetor 2020
Pagesa e hershme e <i>fee</i> -së së konferencës	25 Tetor 2020
Afati përfundimtar i pagesës së <i>fee</i> -së së konferencës	15 Nëntor 2020
Dërgimi i artikullit të plotë	25 Nëntor 2020
Konferenca	3 - 4 Dhjetor 2020

Mbajtja e konferencës

Konferenca do të zhvillohet në kampusin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Dorëzimi i abstrakteve

Pjesëmarrësit janë të lutur të dergojnë abstraktet e punimeve që do i paraqesin në formë referimi ose posterit. Referimet do të zgjasin 10-15 minuta, siç do të vendoset dhe nga organizatorët e sesioneve. Madhësia e posterit duhet të jetë A0 (85 x 120 cm). Afati përfundimtar i dorëzimit të abstraktit të punimit është 20 Shtator. Abstraktet do të dorëzohen në adresën e-mail të konferencës cals@ubt.edu.al. Udhëzimet për përgatitjen e abstraktit jepen në "Formën e abstraktit". Në rastet kur do paraqitet më shumë se një abstrakt, ju lutem dërgojini në mesazhe të veçanta përmes e-mail. Abstraktet e pranuar, do të botohen në librin e abstrakteve, ashtu siç do të dorëzohen nga autorët. Nuk merret përsipër korektimi i tyre.

Botimi i artikullit të plotë

Autorët, abstrakti i të cilëve është pranuar, ftohen të dergojnë artikullin e plotë për publikim në revistën e UBT, *Albanian Journal of Agricultural Sciences (AJAS)* (ISSN 2218-2020) (<https://ajas.ubt.edu.al/>). Artikulli i plotë do të dërgohet në adresën cals@ubt.edu.al, duke përdorur në titullin e mesazhit numrin individual të referencës që do u jepet autorëve në momentin e dorëzimit të abstraktit. Punimet do të botohen në një numër të veçantë të revistës. Artikulli duhet të përgatitet në anglisht, në përputhje me udhëzimet e revists (<https://ajas.ubt.edu.al/guidelines-for-authors>.) dhe është **pa pagesë**.

Formati i abstraktit

Titulli. Duhet të jetë konçiz, informativ. Duhet të jetë në *Times New Roman, 14, bold*, i vendosur në qendër. Këshillohet të evitohen, kur është e mundur, përdorimi i shkurtimeve dhe formulave.

Emrat e autorëve. Të shkruhen në gërma kapitale, *Times New Roman, 10, majtas*.

Adresat. Adresat e autorëve, që përfshijnë departamentin, institucionin, qytetin, shtetin duhet të jenë poshtë emrave. Adresat e ndryshme duhet të tregohen me numra superscript, menjëherë pas emrit të autorit dhe në fillim të adresës përkatëse. Ato duhet të jenë në *Times New Roman, 10, majtas*. Duhet të përdoret një yll, për të treguar autorin e korespondencës. Jepni gjithashtu, adresën e e-mail, numrin e telefonit për çdo autor.

Abstrakti. Duhet të jetë një paragraf i vetëm, dhe të mos ketë më shumë se 200 fjalë. Duhet të jepen qëllimi i kërkimit, të përshkruhet metodologjia e përdorur dhe të përmbliidhen rezultatet kryesore, si dhe të tregohen përfundimet kryesore të studimit. Nuk duhet të përmbajë referenca. Gjithashtu, duhet të shmangen shkurtimeve e pazakonta (duke përjashtuar rastet, kur ato janë përmendur fillimisht në abstrakt). Shkrimi duhet të jetë: *Times New Roman, madhësia 10, justified*, hapsira teke.

Fjalë kyçet. Në fund të abstraktit të jepen jo më shumë se 6 fjalë kyçe, të cilat të mos përsëritin titullin e punimit.

Abstraktet duhet të dërgohen me e-mail në adresën cals@ubt.edu.al

Konferenca "Agriculture a Life Science with roots in Applied Biology" Universiteti Bujqësor i Tiranës, UBT (3-4 Dhjetor 2020)

Regjistrimi

Pjesëmarrësit janë të lutur të regjistrohen, duke plotësuar dhe dorëzuar formën e regjistrimit përmes adresës së e-mail cals@ubt.edu.al. *Fee* e konferencës do të paguhet pasi autorët të marrin njoftimin për pranimin e abstraktit. Pagesa e kryer deri më 25 tetor 2020 është 50 Euro, për pagesat e mëvonshme, pas datës 15 Nëntor 2020 është 100 Euro. *Fee* e konferencës përfshin ndjekjen e plotë të programit të konferencës, materialet e konferencës, pushimet e kafeve dhe drekën. Regjistrimi quhet i pranuar, pasi të jetë bërë transfera e "pagesës së regjistrimit".

Ju lutemi plotësoni formularin e mëposhtëm dhe dërgojeni me e-mail në adresën cals@ubt.edu.al. Një numër reference individuale do ju dërgohet dhe ju do ta përdorni kur të dërgoni abstraktin dhe artikullin e plotë.

Forma individuale e regjistrimit

(ju lutem shkruani me gërma kapitale)

<input type="checkbox"/> Prof <input type="checkbox"/> Dr <input type="checkbox"/> Ms <input type="checkbox"/> Mr			
Mbiemri		Emri	
Institucioni			
Adresa			
Qyteti		Shteti	
tel		Fax	
E-mail			
Titulli i prezantimit			
Mënyra e prezantimit	Referim <input type="checkbox"/>	Poster <input type="checkbox"/>	

Të dhënat e bankës:

Emri: RAIFFEISEN BANK SHA
Adresa: Rruga e Kavajes, Nr. 1, Tirana, Albania
Përfitues: UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES (UBT)
Numri i Llogarisë: 40313128
SWIFT Code: SGSBALTX
IBAN Code: AL51202110750000000040313128
Pagesë për konferencën: *“Agriculture a Life Science with roots in Applied Biology”*
Monedha: Euro

